

2021

PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

**Projekti: “Impianti i trajtimit te ujerave
te ndotura” ID. 6.1**

LEJE MJEDISI – TIPI B

Projekti: "Instalim i trajtimit te ujerave te ndotura" ID. 6.1

Kërkuesi:

**Bankers Petroleum Albania
NIPT: K43128401L**

Përgatitur nga:



Shtator 2021

HYRJE

Kërkuesi Bankers Petroleum Albania me NIPT K43128401L dhe Adresa: Fier, Lagjja "Sheq i Madh", Rruga "Leonardo Murialdo", Godina nr.37, synon te zhvilloje proceduren per aplikim per leje mjedisi të tipit B për aktivitetin Impiant I Trajtimit I Ujërave të Ndotura.

Referuar Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, aktiviteti I synuar është:

ID 6.1 Instalim trajtimi per ujerat e ndotura urbane.

Vendndodhja e aktivitetit është në fshatin Marinëz, Qarku Fier (midis gropave ekologjike 3 dhe 4).

Impianti I trajtimit te ujerave te ndotura urbane eshte ekzistues dhe funksional. Kompania Bankers Petroleum Albania ishte I pajisur me leje mjedisi te tipit C e cila nuk eshte me e vlefshme referuar ndryshimeve ligjore. Per kete arsye BPAL po zhvillon kete procedure per aplikimin e lejes se mjedisit te tipit B.

PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Impianti i trajtimit të ujërave të zeza është e vendosur në veri të Pad H afer Impiantit të trajtimit llumit. Ky objekt ka qenë përdorur për trajtimin e efluentit te hequr nga gropat septike në disa sheshe pusesh duke siguruar përmirësimin e vazhdueshëm në menaxhimin e tij mjedisor të fushës Patos Marinzës.

Impianti eshte plotesisht vetefunksionues duke lejuar nje instalim dhe trajtim te thjeshte dhe te shpejte te ujerave te zeza.

Ujërat hyjnë në dhomen primare e cila është projektuar për të hequr lëndët e ngurta pezull, efluenti i dekantuar është transferuar më pas në një dhome me dy faza te trajtimit biologjik. Llumi që mbledhet do te hiqet në mënyrë periodike nga rezervuari i dekantimit primar dhe do te perdoret si fertilizues.

Faza e trajtimi biologjik përdor një filtër biologjik me ajrim. Ky është një proces me dy faza që lejon përzierjen e vazhdueshëm të rrjedhës hyrëse e vendosur për të siguruar trajtim optimal jo vetem për të reduktuar NBO (Nevojen Biologjike per Oksigjen) në nivelet që kërkohen, por edhe për të arritur reduktimet e azotit amoniakal në kërkesat standarde.

Rezervuari i dekantimit përfundimtar është projektuar për të arritur dekantimin maksimal të çdo lënde të ngurtë pezull para shkarkimit të ujit. Sistemi i propozuar I trajtimit te ujerave të zeza gjithashtu përfshin sisteme të vazhdueshme dhe në kohën e duhur kthen automatikisht llumin nga rezervuari përfundimtar përsëri në rezervuarin primar të dekantimit. Ky është funksion i veçantë që "ushqen" bakteret kur inputet fillestare te ujerave të zeza janë të ulëta. Gjithashtu sistemi i ujerave të zeza siguron riciklimin e vazhdueshëm të lëndës rrjedhëse te trajtuar në rezervuarin primar për të siguruar jo vetëm hollimin e ujerave të zeza në hyrje, por edhe për të siguruar lëndën rrjedhese të vazhdueshme gjatë periudhave kur kemi rrjedhje të ulët ose kur nuk


ka aspak. BPAL operon një proces trajtimi biologjik ne tre faza. Te gjitha jane mbi toke, te lëvizshme dhe mund te ri – dislokohen aty ku kërkohet. Një depozite mbajtëse do te instalohet për te marre dhe siguruar magazinim te përkohshëm te ujerave te zeza nga zonat operationale te BPAL si dhe do te përdoret per te kontrolluar normën e rrjedhës dhe imputin ne sistemin e trajtimit.

Gjithashtu depozita do te përdoret per magazinim te përkohshëm per periudhat kur gjenerimi i mbetjeve dhe shpërndarja është me e madhe se kapaciteti I impiantit te trajtimit per shembull gjate mirëmbajtjes rutine te impiant. Kjo siguron qe impianti operon brenda performances se tij me eficente.

Impianti i trajtimit te ujerave te ndotura është dizenuar si një tank i vetëm i cili inkorporon depoziten e

Trajtimit te Sedimentimit Primare, Trajtimin Biologjike dhe Trajtimin i Sedimentimit Përfundimtare brenda

te njejtës strukture, njësia është vet-përmbajtëse duke lejuar nje instalim te thjeshte dhe te drejtpërdrejte.



Vendndoshja e impiantit te trajtimit te ujerave te ndotura urbane në veri të Pad H midis impiantit të trajtimit të Llumrave.

- Është parashikuar që impianti te trajtojë ujërat e zeza me kapacitetet **40-75 m³/ditë**

Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: X gauss Y gauss
1942_GK_ZONE_4

- 1 4386331 4513065
- 2 4386331 4513066
- 3 4386333 4513067
- 4 4386336 4513067
- 5 4386344 4513073
- 6 4386345 4513077
- 7 4386353 4513078
- 8 4386358 4513078
- 9 4386370 4513080
- 10 4386374 4513080
- 11 4386374 4513079
- 12 4386374 4513076
- 13 4386374 4513070
- 14 4386372 4513065
- 15 4386371 4513063
- 16 4386368 4513062
- 17 4386366 4513061
- 18 4386362 4513061
- 19 4386360 4513061
- 20 4386353 4513060
- 21 4386350 4513059
- 22 4386343 4513054
- 23 4386338 4513052
- 24 4386338 4513053



1.2 Synimet e projektit

Në Shqipëri trajtimi i ujrave te zeza eshte ne shifra mjaft te ulëta. Në mungesë të infrastrukturës së nevojshme të kanalizimeve pjesa dominuese ka zgjedhur grumbullimin e mbetjeve në gropa septike zgjidhje e cila haset edhe në vendburimin e Patos-Marinzës. Aty ku rrjetet e kanalizimeve janë prezente efluenti shkarkohet direkt në rrjedhat ujore sipërfaqësore (kanale, lumenj etj).


Projekti për impiantin e trajtimit të ujrave të zeza synon trajtimin e ujrave të ndotura urbane të cilat do të të kompanisë BPAL. Synimi i projektit është që të sigurojë për zonën trajtimin e ujrave e zeza të gjeneruara në fushën e naftës së Patos-Marinzës nga veprimtaria e kompanisë Bankers. Implementimi i këtij projekti do të çojë në një reduktim të impaktit të operacioneve në sistemin ekzistues të ujërave sipërfaqësorë të kullimit. Ka një numër të programeve të BE-së dhe Bankës

Botërore për të ndihmuar në zhvillimin e sistemeve moderne sanitare, por përparimi ka qenë i ngadalshëm.

MENAXHIMI I INSTALIMIT

Struktura e menaxhimit te instalimit eshte pasqyruar ne vazhdim.

Struktura e menaxhimit



Sistemet e menaxhimit janë të bazuara në ISO 14001, sisteme të marrë në konsideratë nga kërkesat e performances te Korporates Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Standardet e Performancës te Bankes Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

1.3 Fushëveprimi

BPAL ka një leje ekzistuese zhvillimore bazuar në një plan të zhvillimit të infrastrukturës për 25 vjet si dhe lejen mjedisore përkatëse. Projekti gjithashtu mbështetet në Planin e Integruar Sektorial për zhvillimin e sektorit të hidrokarbureve në fushën naftëmbajtëse të Patos Marinzë. Projektet për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve janë në qendër të synimeve të kësaj kompanie duke kontribuar në cilësinë e mjedisit të trashguar.

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS DHE MASA

Shkarkimet ne ajer

Cilësia e ajrit në fushën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës është e ndikuar nga shumë operacione industriale. Bankers Petroleum kryen monitorimin e cilësisë së ajrit në disa vende që ndodhen në të gjithë fushën naftëmbajtëse për të kapur dhëna të përgjithshme të përcaktuara për zonën, përfshirë edhe Impiantin e Trajtimit të Ujerave Ndotura Urbane. Monitorimi i ajrit që kryhet, përfshin të gjitha burimet e emetimeve në ajër që janë të matur përkundrejt normave të lejueshme të cilat përfshijnë të gjitha operacionet BPAL. Të dhënat e Monitorimit i dërgohet AKM në baze tremujore.

Impianti i Trajtimit të Ujërave të Zeza furnizohet me energji elektrike. Prandaj, nuk ka emetime në ajër nga funksionimi i vet impiantit, megjithatë monitorimi i ajrit ndërmerret në bazë gjashtë mujore.

Impianti është instaluar që plotëson udhëzimet teknike të TMD-së. Çdo emetim që është mbi kriteret e parametrave identifikohet në raportet e monitorimit dhe BPAL është i përgatitur për të adresuar mirëmbajtjen e pajisjeve nëse është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur.

Shkarkime ne ujera sipërfaqesore

Cilësia e ujërave të trajtuar të shkarkuara në ujërat sipërfaqësorë nga Impianti i Trajtimit të Ujerave Ndotura Urbane është vlerësuar që të jetë në përputhje me standardet dhe shkarkohet në trupin ujqor të Kanalit të Hoxhës. Të gjithë parametrat janë përfshirë në raportin e VNM. Nuk është identifikuar asnjë ndikim nga monitorimi periodik tremujor.

Uji shkarkohet vetëm kur lejohet, dhe pas testimit në përputhje me VKM Nr 177. Vëllimi, data dhe analiza e shkarkimeve të ujit raportohen siç kërkohet.

Shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë nga Impianti i Trajtimit të Ujerave të Zeza vijnë nga trajtimi i ujërave të ndotura. Ujërat e trajtuara shkarkohen në kanalin kullues dhe më pas në Kanalin e

Hoxhares. Uji i trajtuar testohet rregullisht për të siguruar që uji plotëson kriteret e shkarkimit. Para shkarkimit rezultatet krahasohen me normat e lejuara të shkarkimeve të lëngshme për ujërat teknologjikë (teknologjikë dhe Ujerat urbane) në përputhje me Vendimin e Ministrave të Këshillit nr. 177, datë 31.03.2005. Mostrat e ujit merren për secilën periudhë tre mujore në të cilën po ndodh shkarkimi. Kopjet elektronike të rezultateve i ofrohen AKM-së në baza tremujore.

Shkarkime ne kanalizime

Nuk ka kanalizime ose sisteme kanalizimesh ne fushen e Patos Marinzes.

Ujerat nentokesore

Cilesia e ujërave nëntokësore në fushën Patos Marinëz janë ndikuar nga praktikat historike të dobëta operacionale nga operatorët e mëparshme. Duhet të theksohet megjithatë, se në aspektin e shfrytëzimit të mundshëm të ujërave nëntokësore, depozitimet aluviale te dokumentuara në vend tregojne qe depozitimet aluviale nuk konsiderohen si një aquifer produktiv, dhe testet e përshkueshmërisë kanë konfirmuar se keto depozitime deri në thellësinë 10 m kane përshkueshmëri relativisht të ulët, duke rezultuar ne nje cilesi te ulet te ujit te nxjerre.

Nuk kryhen dhe nuk planifikohen shkarkime në ujerat nëntokësore. Proçeset e infrastrukturës dhe menaxhimit janë në vend për të parandaluar ndikimin në mjedis si rezultat i këtij aktiviteti.

Politika / procedurat e ndërmarrjes HSSE dhe planet specifike të menaxhimit janë vendosur për të parandaluar ose zvogëluar emetimet e ndotësve në tokë, ose ujërat nëntokësore. Monitorimi i ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësorë kryhet sipas kërkesave të DRM, AKM dhe MM për të siguruar që ato të mos preken.

Shkarkime ne toke

Ekzistojne studime dhe dokumenta të shumta lidhur me kushtet ekzistuese te tokes dhe ujerave nentokesore. Me zhvillimin e zones naftembajtese te Patos-Marinzes gjate pothuajse 90 viteve te fundit, ka pasur shume praktika historike qe kane rezultuar ne ndotje te tokes dhe ujerave nentokesore.

Bankers ka larguar këtë ndotje te trashëguar dhe kjo është marrë masa për ruajtjen e sigurt deri në kohën kur operatori i cili është përgjegjes për atë nën Principin Ndotesi Pagan dhe Marrëveshjes Hidrokarbure zhvillon dhe financon planin e tij të veprimit.

Nuk ka shkarkime të lëshuara direkt në tokë sipërfaqësore, megjithatë shkarkimi i trupave të ngurtë në tokë mund të ndodhë në vend, prandaj monitorimi tremujor do të ndërmerret për çdo tremujor në të cilin ndodh kjo. Shkarkimi do të jetë i kufizuar në llumin e trajtuar të ujërave të

zeza, kjo do të hiqet periodikisht nga njësia dhe do të përdoret si një kondicioner tokës nga BPAL në vendin ku synon të promovojë bonifikimin e vendeve të kontaminuara historikisht.

Nuk ka emetime te ngurta ose gjysëm te ngurta qe te përhapen me qëllim në tokë.

Nuk ka shkarkime ne toke nga operacionet ne kete shesh. Kompania BPAL në baze të planit të menaxhimit politikave të HSSE / procedurat në vend janë për të parandaluar ose reduktuar çlirimin e ndotësve në tokë dhe apo në nëntokë. Cilësia e ujërave të cekët nëntokësore monitorohet për të siguruar ndikimet negative.

Gjenerimi I zhurmave

Impianti I Trajtimit te Ujerave te Zeza është e lokalizuar në një zonë me zhvillim industrial historik. Të gjitha pajisjet janë marre duke përdorur teknologjinë më të mirë të disponueshme, dhe përdoren sipas normave të përcaktuara nga prodhuesi, si dhe mirëmbahen nga BPAL në mënyre që të jenë në gjendje të mirë pune. Afër Impianit te Trajtimit te Ujerave te Zeza ka një numër të caktuar impiantesh që operojnë në fushën e Patos-Marinzës. Pikat e monitorimit duke përfshirë dhe Impianin e Trajtimit te Ujerave te Zeza janë të vendosura në afërsi të një numri të instalimeve në të gjithë fushën naftëmbajtëse, për të siguruar një vlerësim të përgjithshëm si dhe kushtet aktuale në terren.

Aktualisht ka zhurmë të gjeneruar si nga Bankers dhe trafiku rrugor i palëve të treta, nga aktivitetet e prodhimit te naftës dhe aktivitetet e ndërtimit brenda zonës së projektit. Faza operacionale e projektit do të kërkojë përdorimin e kufizuar të pompave të lëngjeve dhe ajrit megjithatë niveli I zhurmës së gjeneruar nga ky proces nuk konsiderohet të jetë i rëndësishëm. Do të vendoset larg receptorëve të ndjeshëm siç janë zonat e banuara. Zhurma do të zbutet nga respektimi I procedurave të Bankers. Monitorimi i zhurmës do të ndërmerret për të siguruar që njësia plotëson udhëzimet përkatëse.

Gjenerimi I vibrimeve Nuk shkaktohen vibracione nga paisjet qe perdoren në sheshin e Impiantit të Trajtimit të Ujerave Ndotura Urbane.